



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më 03/07/2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje bazë materiale për „Rehabilitimin e përroit në lagjen e Re, Faza II“, përroi Dukas dhe „Ndërtim të mureve mbajtëse përgjatë rrugës „Ymeraj“, Gjynaqarë me qëllim parandalimin e rrëshqitjes së rrugës”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Materiale ndërtimi dhe produkte të ngjashme 44100000-1

Beton me përzierje të gatshëm 44114100-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,185,311 (gjashtë milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, venë në dispozicion nga të ardhurat lokale 2025, për objektin: “Blerje bazë materiale për „Rehabilitimin e përroit në lagjen e Re, Faza II“, përroi Dukas dhe „Ndërtim të mureve mbajtëse përgjatë rrugës „Ymeraj“, Gjynaqarë me qëllim parandalimin e rrëshqitjes së rrugës”

Nga të cilat:

4,166,667 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH. Nga fondi kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2025.

2018,644 (dy milion e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH. Nga fondi i pakushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2025.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatesisht **2,474,124.4 (dy milion e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet e katër pikë katër) Lekë.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$6,185,311 \times 40\% = 2,474,124.4 \text{ Lekë.}$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2024.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do

të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht **1,237,062.2 (një milion e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e dy pikë dy) Lekë.**

(apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohe për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

6,185,311 x 20% = 1,237,062.2 Lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të vetdeklaroj se merr përsipër furnizimin (dorëzimin, ngarkimin dhe shkarkimin) e mallit objekt prokurimi për zërat e preventivit:

TABELA A				
Nr	Nr. Analize	Emertimi i materialeve	Njesia	Sasia
2	3.401	Gjeotekstil me gramature 180 g/m2	m2	2900
4	2.166	Hekur betoni i periodik Ø 6 mm2	kg	8800
5	2.166	Tel bari	kg	72.86
6	2.602	Derrase pishe fm e stazhonuar (2.5 cmx10cmx3)	m2	100
7	2.602	Gozhde	kg	45

TABELA B				
Nr.	Analize	Emertimi i materialeve	Njesia	Sasia
2	2.166	Hekur betoni periodik Ø 10 mm	kg	6800
4	treg	Binare (6x12)cm	m3	2
5	treg	Betoforma (60x300)cm	m2	100
6	1	Gozhde	kg	20

Do të magazinohen pranë ambjenteve të Agjencisë së Shërbimeve Publike Patos në prani të komisionit të ngritur me urdhër të titullarit për marrje në dorëzim, si dhe vetdeklaroj se operatori mban përgjegjësi dhe zëvendëson të gjitha materialet që dëmtohen gjatë rrugës dhe gjatë procesit të ngarkim-shkarkimit.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për ti vertetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklaroj se do të dorëzoj mallin sipas zërave të preventivit:

TABELA A				
Nr	Nr. Analize	Emertimi i materialeve	Njesia	Sasia
1	2.701	Çakell	m3	150
3	1.29/p	Beton C-16/20 (Me zall) per veshje t=10cm	m3	288

TABELA B				
Nr.	Analize	Emertimi i materialeve	Njesia	Sasia
1	1.29/p	Beton C16/20 (me cakell)	m3	156.4
3	3.183/a	Zhavorr per nenshtrese	m3	28

Sipas kërkesës dhe nevojave faktike të Autoritetit Kontraktor zërat e mësipërm do të transportohen direkt në vepër sipas kërkesës dhe sasisë së nevojshme të përcaktuar paraprakisht nga Autoriteti Kontraktor.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për ti vertetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qira, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Autobetoniere	në pronësi ose me qera	Copë	2
2	Auto Pompë Betoni	në pronësi ose me qera	Copë	1

3	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës ≥ 20 ton	në pronësi ose me qera	Copë	1
---	---	---------------------------	------	---

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet:
 - dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë);
 - leje qarkullimi;
 - certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme);
 - siguracion mjeti (i vlefshëm);
 - certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet:
 - kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi;
 - dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë)
 - leje qarkullimi;
 - certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
 - siguracion mjeti (i vlefshëm);
 - certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c. Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- d. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- e. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- f. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- g. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pikës 5/ç nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Këto mjete janë kërkuar nisur nga sasia e konsiderueshme e mallrave objekt prokurimi. Gjithashtu furnizimi i sasisë së materialit objekt prokurimi kërkon si nevojshmëri për realizimin e kontratës tre mjetet të cilët do të furnizojnë sipas nevojave të AK mallin e kërkuar dhe 1 mjet që do të shkarkojë materialin në prani të komisionit dhe stafit teknik të Agjencisë së Shërbimeve Publike të cilët do të kryejnë proceset e tjera

2.3.5. Operatori Ekonomi duhet të ketë fabrikë betoni (në Pronësi osë me qera) e paisur me Leje mjedisore KODI III.1B jo më larg se 20 km nga objekti ku do të realizohet ndërhyrja kjo bazuar në DIN EN 206-1: Intervali midis dy ngarkesave për të njejtin kallëp nuk i kalon 30 minuta. Koha midis përzierjes së ujit me cimenton dhe agregatet, apo të cimentos me agregatet si dhe vëndosja e betonit në kallop nuk e kalon një orë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është e domosdoshme për të provuar që Operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas legjislacionit në fuqi.

Në rastet kur fabrika e betonit nuk është në pronësi apo me qera nga operatori ekonomik por me kontratë furnizimi, operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë që furnizuesi i mallit të ofertuar disponoj lejen si më lart.

2.3.6. Certifikat ISO:

ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise(e vlefshme), Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi: Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi , e cila mundeson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke***

argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikime teknike:

Furnizimi dhe ruajtja

Betoni i parapërgatitur në fabrikë nuk duhet të furnizohet pa u vendosur të gjitha kallëpet, armimet dhe elementët e tjerë të lidhura me to. Betoni duhet të jetë në konformitet të plotë me pjesët e aplikueshme të standartit DIN EN 206-1.

Materialet duhet të magazinohen në paketimin e tyre origjinal të padëmtuar në një vend të mbrojtur nga elementët dhe të thatë, deri sa të jenë të gatshëm për përdorim.

Çimentoja dhe përbërësit e saj duhet të ruhen veçmas nga materialet e tjera të cilat nuk janë të përshtatshme për prodhimin e betonit dhe që mund të dëmtojnë cilësinë e tij.

Betoni i parapërgatitur në kushtet e fabrikës:

Betoni i parapërgatitur duhet të furnizohet me kamion përzierës dhe do të pranohet nëse është në përputhje me kërkesat e standartit DIN EN 206-1.

Prodhuesi i betonit të parapërgatitur duhet të paraqesë fletën e furnizimit për çdo ngarkesë betoni në dy kopje. Përveç kërkesave të standartit DIN EN 206-1, fleta e furnizimit duhet të paraqesë informacionin e mëposhtëm:

- Tipi dhe marka e çimentos
- Përqindja e çimentos për çdo metër kub beton
- Madhësia maksimale e agregateve
- Sasia totale e ujit e shprehur si raport Ujë/Çimento
- Numri i identifikimit të kamionit
- Volumi i betonit në kamion
- Koha e prodhimit

Betoni duhet të përzieret vazhdimisht dhe fleta e furnizimit duhet të kërkohej për çdo ngarkesë që është gati për tu përdorur. Përzierja e betonit duhet të fillojë brenda 30 minutash pasi çimentos i janë shtuar agregatet.

Përzierje betoni M 200

- masa maksimale e agregatit 20 mm

- përmbajtja minimale në çimento 290 kg/m³
- raporti maksimal ujë i palidhur/çimento 0.65

Hedhja e Betonit në kallëp:

Betoni duhet të hidhet në kallëp brenda 90 minutave nga përzierja e ujit me çimenton në qoftë se temperatura e ajrit është më pak se 30 gradë Celsius. Kjo kohë duhet reduktuar në 60 minuta në qoftë se temperatura e ajrit është më e madhe se 30 gradë Celsius.

Betoni nuk duhet të hidhet në kallëp nëse:

- (a) kushtet e motit pengojnë hedhjen e betonit dhe konsolidimin e tij;
- (b) në zonat e pambuluara gjatë periudhave të reshjeve;
- (c) kur uji është i pranishëm brenda formës.

Para hedhjes së betonit, duhen hequr papastërtitë, mbeturinat e ndërtimit nga betoformat. Betoni nuk do të lejohet të bjerë në rënie të lirë nga një lartësi më e madhe se 3 m për të parandaluar ndarjen e elementeve përbërës.

Sipërfaqja duhet të nivelohet duke sheshuar të gjitha parregullësitë.

Temperatura minimale e betonit duhet të ruhet mbi 10 gradë celsius. Betoni nuk duhet të hidhet kur temperatura e ambientit është nën 5 gradë Celsius. Temperatura maksimale e betonit duhet të jetë jo më shumë se 32 gradë celsius.

Pompat e Betonit:

Pompa e Betonit do të operohet dhe mirëmbahet në mënyrë që të sigurojë një rrjedhë të vazhdueshme pa krijuar xhepa ajri, ndarje të aggregateve ose ndryshime të uljes së konusit (slump test) me më shumë se 5 centimetra.

Uji për beton

Uji që do të përdoret në prodhimin e betonit duhet të jetë i pastër nga substancat që dëmtojnë atë si: acidet, alkalidet, argila, vajra si dhe substanca të tjera organike. Në përgjithësi, uji i tubacioneve të furnizimit të popullsisë (uji i pijshëm) rekomandohet për përdorim në prodhimin e betonit.

Kallëpet:

Kallëpet duhet të vendosen në mënyrë të saktë dhe të puthiten mirë te cepat për të mos lejuar rrjedhjen e betonit. Nyjet, cepat dhe këndet e ekspozuara duhet të rrumbullakosen (me një prerje 20 milimetra) me perjashtim të rasteve kur kjo nuk është e nevojshme. Para vendosjes së kallëpeve ato duhet të lyhen me substanca që parandalojnë ngjitjen e tyre me betonin dhe që nuk lënë shenjë mbi betonin apo kallëpin.

Para se të ripërdoren, të gjitha kallëpet duhet të rikondicionohen dhe të gjitha sipërfaqet e kallëpeve duhet të pastrohen pa shkaktuar dëmtime të sipërfaqes së kallëpeve.

Pozicionimi i armaturave:

Pozicionimi i shufrave të armimit duhet të bazohet në vizatimet e projektit dhe të fiksohet në pozicionin e duhur gjatë gjithë procesit të hedhjes së betonit. Shufrat e armimit duhet të mbahen të mbështetura mbi blloqe prej betoni ose prej çeliku, apo mbi distancues, doreza çeliku, apo fiksues të tjerë që përmbushin të njëjtat funksione.

Hekur betoni periodik Ø6-10 mm

Shufrat e çelikut duhet të jenë në përputhje me kërkesat e Eurokodit 2, EN 10080. Çeliku i armimit do të jetë i klasës S500 dhe pa prezencë ndryshku.

Gjeotekstil

Pëlhura gjeotekstil shërben kryesisht për drenazhimin e punimeve të ndërtimtarisë. 100% e bërë nga fibra sintetike, kryesisht poliestër, pa resina dhe mbetje toksike. Me rezistencë maksimale ndaj shpimit dhe shtypjes, përshkueshmëri të shkëlqyeshme, e përshtatshme për të kontrolluar erozionin e argjinaturës në punët e restaurimit mjedisor dhe hidraulik, nuk bashkëvepron me acidet, largon mykun.

Materiali: TNT fibra poliestri

Inertët

Për prodhimin e betonit realizimi duhet të bëhet duke respektuar Agregatet duhet të zgjidhen në përputhje me DIN EN 206. Ato duhet të jenë të fortë dhe të qëndrueshem dhe nuk duhet të përmbajnë materiale të dëmshme që veprojnë kundër fortësisë ose qëndrueshmërisë së betonit ose, në rast të betonarmesë mund të shkatërrojnë këtë përforsim.

- Çakëlli do të jetë “çakëll makinerie” me madhesi 2-10 cm

Gozhdë

Materiali Hekur, Përdorimi: Dru

Specifikimet dhe kriteret teknike u hartuan nga **DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE** duke marrë në konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, e nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilesise” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **14/07/2025, ora 11:00**.

I. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje bazë materiale për „Rehabilitimin e përroit në lagjen e Re, Faza II“, përroi Dukas dhe „Ndërtim të mureve mbajtëse përgjatë rrugës „Ymeraj“, Gjyngarë me qëllim parandalimin e rrëshqitjes së rrugës”**.

II. Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij procesverball:

Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT

Florian Kita

Ermenita Mici

Shkëlqim Xhaferi